


S T A T U T
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "LINDA-80" SH.P.K.



H Y R J E

NENI 1

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "LINDA-80" SH.P.K. krijohet mbi bazën e iniciativës dhe kapitalit themeltar të ortakut të vetëm, Zotit Nikoll Marnikollaj në bazë të aktit të themelimit datë 05.02.2001 për të ushtruar aktivitetin e saj privat si person juridikë i pavarur.

NENI 2

Shoqëria krijohet dhe e zhvillon veprimtarinë e saj në përputhje me normat e këtij Statuti, Ligjit 7638 datë 19. 11. 1992 "Për Shoqëritë Tregtare" si dhe Legjislacionit në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

NENI 3

Kjo shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, i përballon humbjet e saj deri në kufirin e rrethës së kapitalit themeltar.

EMËRTIMI, SELIA, OBJEKTI, KOHËZGJATJA

NENI 4

Emërtimi i Shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar është: "LINDA-80" SH.P.K.

NENI 5

Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar ka qendrën e saj në Rrilë - Lezhë. Aktiviteti i Shoqërisë do të zhvillohet në Rrilë - Lezhë dhe do të shtrihet në të gjithë territorin shtetëror të Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj.

O B J E K T I

NENI 6

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë "LINDA-80" Sh.p.k. do të jetë: Transport udhëta të shprehur brenda dhe jashtë vendit; Import eksport dhe tregtim me shumicë dhe pakicë të mallrave industriale, ushqimore, plogjorale, bujqësore, materialeve të ndërtimit, lëndëve të para, pajisjeve elektrike, elektronike, ngjyeno-sanitare, hidraulike, duraluminit, pllakave të të gjitha llojeve, plastikës, gomës, ëndës drusore e mobiljeve, makinave të të gjitha llojeve e tonazheve, pjesëve të këmbimit, makinerive të ndryshme, konfeksioneve, parfumerisë; kancelarisë e materialeve e pajisjeve për zyra hapjen e bar restoranteve si dhe investime në fusha të ndryshme.

NENI 7

Shoqëria themelohet për të ushtruar veprimtarinë e saj për një periudhë mbi 20 vjet, duke filluar nga koha e regjistrimit në regjistrin tregëtar të Gjykatës së Tiranës. Për shkaqet e arsye të ndryshme, ajo mund të mbarojë aktivitetin e saj dhe para këtij afati. Kjo do të bëhet në përputhje me normat e Statutit dhe Legjislacionit në fuqi.

KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISË

NENI 8

Kapitali themeltarë i Shoqërisë përbëhet nga kontributi i ortakut të vetëm, Zoti Niloll Marnikollaj, me shumën 100.000 (njëqind mijë) lekë.

NENI 9

Kapitali i Shoqërisë depozitohet para fillimit të aktivitetit të Shoqërisë.

NE NI 10

Kapitali themeltar mund të shtohet ose të zvogëlohet, në varësi të rezultateve dhe në përputhje me normat e legjislacionit në fuqi. Ai mund të jetë në lekë ose në valutë të huaja.

NE NI 11

Kapitali themeltar mund të transferohet jashtë Shoqërisë, ose të lihet peng, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

NE NI 12

Kapitali themeltar është lentësishtë i transferueshëm në rrugë trashëgimie Bashkëshorti, paraardhësit dhe pasardhësit mund të bëhen ortakë në Shoqëri nëpërmjet transferimit të pjesëve të kapitalit dhe sipas kushteve të parashikuara me ligj.

NE NI 13

Shoqëria mund të ketë dhe kontribute të tjera në natyrë. Këtu përfshihen ë gjitha sendet e paluajtëshme në shërbim të Shoqërisë si dhe ato të luajtëshme, të cilat kalojnë në pronësi të Shoqërisë.

FONDET E SHOQËRISË

NE NI 14

Shoqëria përcakton fondet:

- Fondi themeltar (qarkullues);
- Fondi rezervë;
- Fonde të tjera, që mund të jenë ë nevojshme gjatë veprimtarisë së saj.

Madhësia e secilit fond përcaktohet rrethi bazën e vendimit të organit drejtues, i cili merr vendim gjithashtu edhe për qëllimin e përdorimit të tij.

DREJTIMI ADMINISTRATIV

NE NI 15

Shoqëria ka si organe drejtuese: 1 Asambleja e ortakëve (Ortaku i vetëm) dhe Administratori. Ortak i vetëm dhe administrator i shoqërisë është Zoti Nikoll Marnikollaj.

NE NI 16

Ortaku i vetëm, për administrimin e Shoqërisë ose të aktiviteteve të veçanta të saj ka kompetencë të emëroje një ose disa persona të tjerë si administratorë të Shoqërisë. Kompetencat e administratorëve të mundshëm përcaktohen në aktin e emërimit të tyre të lëshuar nga ortaku i vetëm.

NE NI 17

Shoqëria nuk merr përsipër veprimet që mund të kryejnë administratorë të tjerë të mundshëm, në marrëdhënie me persona të tretë që i tejkalojnë kompetencat e tyre të përcaktuara në aktin e emërimit.

NE NI 18

E gjithë veprimtaria e Shoqërisë përcaktohet nga administratori i saj në përputhje me Statutin dhe legjislacionin në fuqi.

NE NI 19

Administratorja për të shqyrtuar bilancin vjetor, të ardhurat e qarkulluara, si dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrave të veprimeve kontabël, emëron një ose disa ekspertë kontabël. Emërimi i ekspertëve kontabël është i detyrueshëm për rastet e parashikuara me ligj.

KOMPETENCAT E ORTAKUT TË VETËM

NE NI 20

Për sa kohë që Shoqëria do të përbëhet nga një ortakë i vetëm, kompetencat e tij do të jenë:

- Vendos për ndryshimet në Statutin e Shoqërisë dhe miraton rregulloret për sektorët e veçantë të saj
- Emëron dhe shkarkon administratorët dhe përcakton kompetencat e tyre në aktin e emërimit.
- Shqyrtor bilanci vjetor, kuotat e fondeve të ndryshme dhe fitimin e realizuar.
- Vendos për krijimin e filialeve, degëve ose përfaqësive të Shoqërisë si dhe për krijimin e shoqërive të përbashkëta.
- Vendos për marrjen e kredive si dhe për mbarimin e aktivitetit të Shoqërisë, nëse në dokumentacionet financiare, rezultatet e Shoqërisë vlerësohen me humbje.
- Realizon marrëdhëniet më të rëndësishme financiare dhe ekonomike të Shoqërisë me persona të tjerë fizikë dhe juridikë.

KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

NE NI 21

Administratori e shoqërisë ka për detyrë:

- Të punojë, të crejtojë e të organizojë në mënyrë të tillë që të sigurojë suksesin e Shoqërisë në veprimtarinë e saj ekonomiko-financiare;
- Të zbatojë vendimet e marra nga ortaku dhe urdhërat e tij, të dhëna brenda kompetencave të përcaktuara nga Statuti i Shoqërisë dhe legjislacioni në fuqi;
- Të paraqesë në mënyrë të rregullt raportin e administrimit, të inventarit, bilancit dhe të llogarive vjetore, ortakëve brenda një afati 6 muaj pas mbylljes së vitit financiar paraardhës;
- Realizon dhe përcakton çmimet e punimeve të kryera si dhe të shitjeve të artikuljeve të tregtuar.
- Vendos për pagat e personelit të Shoqërisë
- Ndjek problemet e Shoqërisë në marrëdhëniet me organe të ndryshme shtetërore dhe me persona të tjerë fizikë dhe juridikë.

MARRËDHËNIET FINANCIARE

NE VI 22

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "LINDA-80" SH.P.K., mund të lidhë kontrata me sektorë shtetërorë, drejtpërdrejt me tregun e lirë, si dhe me persona fizikë e juridikë, vendas ose të huaj.

NE VI 23


Në marrëdhëniet kontraktore, Shoqëria përfaqësohet nga ortaku i vetëm ose nga persona të autorizuar prej tij. Të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kontratat janë të detyrueshme për Shoqërinë.

NE VI 24

Shoqëria ka të drejtë të plotë të çelë llogari likuiduese pranë Bankave të vendit ose të huaja në Shqipëri, shtetërore ose private dhe të kryejë veprimet e likuidimit nëpërmjet tyre. Për sigurimin e veprimtarisë ka të drejtë të vetëfinansohet në lekë ose në valutë të huaj.

NE VI 25

Shoqëria përgjigjet për kontributet fiskale, afatet e derdhjes së tyre dhe sigurimet shoqërore. Personat e ngarkuar me këtë detyrë duhet të mbajnë dokumentacion të rregullt financiar.



Administratori në fund të vitit duhet të dorëzojë në organin tatimor përkatës bilancin e të ardhurave për efekt të tatimit vjetor.

Viti financiar mbaron në muajin dhjetor të çdo viti. Raportet dhe inventaret vjetore hartohen nga ortaku i vetëm në përputhje me dispozitat e këtij Statuti dhe Legjislacionin në fuqi.

MARRËDHËNIET E PUNËSIMIT

NE/II 26

Ortaku i vetëm vendos për personat që do të punësohen në aktivitetin e Shoqërisë. Punësimi do të bëhet në përputhje me aftësitë profesionale të punëmarrësit.

NE/II 27

Marrëdhëniet e punësimit rregullohen sipas kontratës së punësimit që lidhet me dis palëve, në bazë të Kodit të Punës dhe akteve ligjore e nënligjore në fuqi. Në kontratë caktohen kushtet e punës, të pagesës, sigurimit në punë ditëve të pushimit etj.

NE/II 28

Administratori dhe personeli i Shoqërisë është i detyruar të respektojë disiplinën e punës, të ruajë dhe të mirëmbajë pronën dhe të zhvillojë aktivitetin e Shoqërisë në përputhje me ligjin.

NE/II 29

Ndaj shkeljeve të ndryshme zbatohen masa disiplinore që merren nga ortaku i vetëm. Punonjësi që largohet nga puna duhet të bëjë dorëzimet e detyrës në bazë të një akti në shkrim, pasi të ketë shlyer detyrimet materiale dhe monetare.

PËRGJEGJËSIA E PUNONJËSVE

NE/II 30

Çdo punonjës i punësuar në Shoqëri është personalisht përgjegjës për kryerjen e detyrës. Ai është i detyruar të përmbushë detyrimet që rrjedhin nga kontrata e punës, nga vendimet e administratorit dhe nga Statuti i Shoqërisë. Për shkelje të tilla dhe për shkelje të Legjislacionit në fuqi merren masa të ndryshme sipas ligjit.

KONFIDENCIALITETI

NE/II 31

Të gjithë personat që do të punësohen në shoqëri janë të detyruar të ruajnë fshehtësinë e dokumentacionit, të informacionit, të njohurive të fituara si dhe të çdo lloji materiali tjetër konfidencial.

Ata duhet të adaptojnë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar hapjen e këtyre qoftë edhe pjesërisht.

BILANCI DHE TË ARDHURAT

NE/II 32

Të ardhurat neto, pas shlyerjes së detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore dhe detyrimeve të mundshme ndaj personave të tretë, kalojnë në dispozicion të ortakut të vetëm Zoti Nikoll Mamkolaj, e cila mund t'i depozitojë në një bankë të vendit ose të huaj, në lekë dhe valutë.

NE/II 33

Pagesat e personelit bëhen sipas kushteve të përcaktuara në kontratën e punës dhe përqindjeve të fitimit të përcaktuara nga ortaku i vetëm.



NENI 34

Në rast të mbarimit të veprimtarisë së Shoqërisë, fitimi i realizuar duke zbritur ose duke shtuar përqir djet e mbartura nga vitet e mëparshme, kalojnë në dispozicion të ortakut të vetëm Zotit Nikoll Marnikollaj.

NENI 35

Çmimet e shërbimeve të ofruara nga Shoqëria si dhe ato të tregtimit caktohen në bazë të parimeve të ekonomisë së tregut të lirë. Fitimet e realizuaraë i nënshtrohen tatimit vjetor të përcaktuar në dispozitat përkatëse ligjore.

SHPËRBËRIA E SHOQËRISË

NENI 36

Veprimtaria e Shoqërisë mbaron me vendim të organit drejtues, në rast se veprimtaria e saj nuk rezulton fitimprurëse si dhe për shkaqe të parashikuara me ligj.

NENI 37

Shoqëria mund të mbarojë edhe me anë të riorganizimit, nëpërmjet formave të thirrjes ose të bashkimit

NENI 38

Gjatë fazës së likuidimit, përgjegjësia e administratorit dhe likuidatorit është e njëjtë

DISPOZITA TË FUNDIT

NENI 39

Pasuria e Shoqërisë mund të sigurohet në ndonjë institut sigurimi.

NENI 40

Mosmarrëveshjet në marrëdhënie me persona juridikë e fizikë, vendas e të huaj, zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt gjykata kompetente është Gjykata e Rrethit Tiranë.

NENI 41

Çdo gjë tjetër në këtë Shoqërië i referohet Ligjit Nr. 7638, datë 19. 11. 1992 dhe çdo akti tjetër të legjisacionit shqiptar.

NENI 42

Shoqëria co të ketë vulën e saj forma dhe përmbajtja e së cilës përcaktohet nga ortakut i vetëm i Shoqërisë.

Statulli Shoqërisë u miratua nga ortakut i vetëm dhe administratori i saj dhe u nënshkrua rregullisht prej tij.

ORTAKU I VETËM
Nikoll Marnikollaj

Nikoll Marnikollaj
